



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01 Nr.104/02-11055/25
Kaçanik, 30.05.2025

Në mbështetje të nenit 24 dhe 40.2(b) të Ligjit Nr.03/L-040 – Për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/4 Qershor 2008), të nenit 27 të Ligjit nr.03/L-048 – Për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 27/03 Qershor 2008), të nenit 2 të Ligjit Nr.03/L-049 – Për Financat e Pushtetit Lokal (Gazeta Zyrtare Nr. 27/03 Qershor 2008) si dhe Ligjit për Ndryshimin e Ligjit Nr.03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/03 Gusht 2016), të nenit 6 të Ligjit 08-L/332 për Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025 (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës 22/2024, publikuar me 12.12.2024), të nenit 34.5 të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e mbajtur me 30 maj 2025, mori këtë:

V E N D I M

PËR BARTJEN E MJETEVE VETANAKE TË PA SHPENZUARA NGA VITET PARAPRAKE NË BUXHETIN E KOMUNËS TË VITIT 2025

1. Me këtë Vendim, bëhet bartja e mjeteve vetanake të pashpenzuara nga viti fiskal 2023 dhe 2024 në buxhetin e komunës të vitit 2025.
2. Shuma e mjeteve për bartje nga viti fiskal 2023 në vitin fiskal 2025 është 409,873.41 euro, ndërsa shuma e mjeteve për bartje nga viti fiskal 2024 në vitin fiskal 2025 është 623,167.70 euro (përfshirë tejkalimin e të hyrave). Totali i mjeteve të pashpenzuara nga vitet 2023 dhe 2024, të cilat kërkohen të barten në vitin 2025 është në shumë prej **1,033,041.11** euro.
3. Buxheti i Komunës së Kaçanikut i miratuar për vitin 2025 në shumë prej 12,592,239.00 euro, pas bartjes së mjeteve të pa shpenzuara nga vitet paraprake në shumë prej **1,033,041.11** euro, do të arrijnë shumën e përgjithshme prej **13,625,280.11** euro.
4. Shuma e planifikuar e te hyrave vetanake për vitin 2025 ka qenë **924,200.00** euro ndërsa realizimi total (direkte dhe indirekte) është **980,670.00** euro dhe tejkalimi i te hyrave rezulton me shumën prej **56,470.00** euro, të cilat janë planifikuar të barten te kategoria ekonomike e investimeve kapitale për vitin 2025.
5. Mjetet e pa shpenzuara në shumë prej **1,033,041.11** euro, janë planifikuar të barten si vijon:
 - Mallra dhe Shërbime, shuma prej 59,502.41 euro;
 - Shërbime Komunale, shuma prej15,803.12 euro;
 - Subvencione dhe Transfere, shuma prej50,954.44 euro; dhe
 - Shpenzime Kapitale, shuma prej906,781.14 euro.

ARSYETIMET PER BARTJEN E MJETEVE:

PB – Administrata dhe Personeli - nënprogrami (16328):

KE – Shpenzime Kapitale:

Shuma prej 10,000.00€ ne projektin 52636-“Rregullimi i sistemit të ngrohjes qendrore të objektit te Administratës komunale"

Plotësim i buxhetit për shkak të ekzekutimit të mjeteve për obligimet e Kontratës Kolektive ne Arsim nga ndarjet buxhetore të vitit të kaluar dhe për shkak te mbulimit te obligimeve kontraktuale te vitit 2025.

PB – Buxhet dhe Financa - nënprogrami (17528):

KE – Shpenzime Kapitale:

Shuma prej 120,000.00€ ne projektin 86245-“Mjetet për bashkëfinancim te projekteve"

Plotësim i buxhetit për shkak te mbulimit te gjitha marrëveshjeve te arritura përmes bashkëfinancimit te projekteve me donatorët tjerë si:

- a)Rregullimi dhe asfaltimi i rrugës Stagovë-Runjevë, shuma prej 66,633.24 euro;
- b)Mamografia per QKMF, shuma prej 38,043.48 euro;
- c)Ridizajnimi i hapësirës së Parkut të Qytetit përballë Kalasë së Qytetit, shuma prej 20,000.00 euro;
- d)Hapja e puseve te ujit për institucionet publike, shuma prej 33,498.98 euro.

PB – Infrastruktura rrugore - nënprogrami (18028):

KE – Shpenzime Kapitale:

Shuma prej 52,984.54€ ne projektin me kod 51631 “Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës Idriz Seferi” (Plotësim i buxhetit për obligimet kontraktuale - aktive);

Shuma prej 78,197.57 ne projektin me kod 52705 “Ndërtimi i trotuarit në rrugën regjionale Ahmet Kaçiku segmenti Restaurant Natyra-Fushë e Pajtimit (Plotësim i buxhetit për obligimet kontraktuale – aktive, faza II);

Shuma prej 64,500.00€ ne projektin me kod 52820 “Ndërtimi dhe rregullimi i hapësirave publike (te udhëkryqi te Lushi-Doganaj-Rruga Avdyl Dura-Duraj-Rr. Vëllezërit Çaka-Kaçanik dhe rr. Zylfi Çaka-Bob (Projekt i planifikuar me Grant Performance, vlere e parashikuar e projektit 225,879.03);

Shuma prej 31,177.85€ ne projektin me kod 55191 “Ndërtimi i trotuarit dhe ndriçimi publik në rrugën "Fadil Bunjaku" Biqec (Plotësim i buxhetit për kontratën aktive);

Shuma prej 24,554.41€ ne projektin me kod 50170 “Ndërtim i objektit te zjarrfikësve” (Plotësim i buxhetit për obligimet kontraktuale-aktive);

Shuma prej 12,000.00€ ne projektin me kod 52879 “Ndërtimi i kanalizimeve fekale dhe atmosferike ne lokalitetet (Kaçanik,Dubravë,Kaçanik I Vjetër, Ivajë, Shtrazë dhe Doganaj) (Plotësim i buxhetit për obligimet kontraktuale-aktive);

KE – Subvencione dhe Transfere, shuma 9,855.97€: (Bartje konform mbetjeve për mbulimin e shpenzimeve mortore).

KE – Mallra dhe Shërbime, shuma 30,876.76€: Bartje e mjeteve nga mbetjet ne KE-Mallra dhe Shërbime të së njëjtit nenprogram prej 18,313.28 euro dhe nga KE-Shërbime Komunale nga nenprogramet tjera si: (75636;85028;16328) prej 12,563.48 euro të vlerësuara si të panevojshme, barten në nenprogramin 18028, për përmbushjen e obligimeve në dhe nevojave gjithnjë në shtuarje për kontratat aktive të mirëmbajtjes investive (mirëmbajtja e hapësirave gjelbëruese, rrugëve lokale, ndriçimit publik dhe mirëmbajtje tjera te domosdoshme.

PB – Zhvillimi Ekonomik - nënprogrami (48028):

KE – Shpenzime Kapitale:

Shuma prej 38,710.00 € në projektin me kod 52893 “Ndërtimi i shkallëve te Guri Shpuar” (Plotësim i buxhetit për obligimet kontraktuale-aktive);

Shuma prej 15,000.00 € në projektin me kod 54406 “Ndërtimi i shtegut të Lirisë” (Plotësim i buxhetit për obligimet kontraktuale-aktive);

KE – Subvencione dhe Transfere, shuma 11,820.12€ (Plotësim buxheti sipas mbetjeve për financim te projekteve te ndryshme).

PB – Planifikimi Urban dhe Mjedisi - nënprogrami (66445):

KE – Shpenzime Kapitale:

Shuma prej 99,786.67 € ne projektin me kod 55169 Rregullimi dhe asfaltimi i rrugëve në pjesën rurale-Kaçanik në fshatrat:

Kaçanik Vjetër, Begracë, Stagovë, Dubravë, Biqec, Kovaçec, Soponicë, Bajnicë. (Plotësim i buxhetit per obligimet kontraktuale);

Shuma prej 9,771.00 € ne projektin me kod 51231 Ndërtimi dhe rregullimi i Qarshisë së Vjetër të Qytetit (Plotësim i buxhetit për obligimet kontraktuale);

Shuma prej 30,102.75.00 € ne projektin me kod 55167 “Rregullimi dhe asfaltimi i rrugëve ne pjesën urbane-Kaçanik: Qendra (mes rrugëve Sali Bajra,Qamil Ilazi dhe Skenderbeu); Bob; Dushkajë; Rruga Idriz Seferi. (Plotësim i buxhetit për obligimet kontraktuale).

Shuma prej 62,496.25€ ne projektin me kod 55167 “Ndërtimi i nënkalimit për këmbësorë nen hekurudhën e qytetit” (Bartje e mjeteve për iniciimin e procedurave te prokurimit për realizimin e punimeve te fazës finale të projektit).

KE – Mallra dhe Shërbime, shuma 5,425.36€: (Bartje e mjeteve për obligimet rreth pagesave për hartimin e projekteve).

PB – Kultura, Rinia dhe Sportet (85028):

KE – Shpenzime Kapitale:

Shuma prej 50,000.00€ ne projektin me kod 45087 “Rregullimi i varrezave të Dëshmorëve dhe Veteranëve të UÇK-ës. (Plotësim i buxhetit për obligimet kontraktuale);

Shuma prej 97,000.00€ ne projektin me kod 56344 (Plotësim buxheti për investimet e reja ne infrastrukturën ne sektorin për rini dhe sport).

PB – Arsimi fillor, i mesëm, i ulët – nënprogrami (93810):

KE – Shpenzime Kapitale:

Shuma prej 50,500.00 € ne projektin me kod 56203 “Ndërtimi i Aneksit dhe rrethojës ne SHFMU Dituria-Shtrazë. (Plotësim buxheti për shkak te pamjaftueshmërisë së planifikimeve te mëhershme buxhetore);

KE – Shpenzime komunale, shuma 7,682.92€

PB – Arsimi i Mesëm, i Lartë – nënprogrami (95010):

KE – Shpenzime Kapitale:

Shuma prej 50,000.00 € ne projektin me kod 54433 “Ndërtimi i aneksit të IAAP-Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka” (Plotësim i buxhetit për shkak të ekzekutimit të mjeteve për obligimet e Kontratës Kolektive ne Arsim nga ndarjet buxhetore të vitit të kaluar);

KE – Shpenzime komunale, shuma 3,117.43€

PB – Administrata (92140):

KE – Shpenzime Kapitale:

Shuma prej 10,000.00 € ne projektin me kod 10,000.00. (Plotësim i buxhetit për shkak të ekzekutimit të mjeteve për obligimet e Kontratës Kolektive ne Arsim nga ndarjet buxhetore të vitit të kaluar)

PB – Arsimi parashkollorë (92750):

KE – Mallra dhe Shërbime, shuma 12,425.29€:

KE – Shpenzime komunale, shuma 5,002.77€:

PB – Bujqësia, Pylltaria dhe Zhvillimi Rural - nënprogrami (47028):

KE – Subvencione dhe Transfere, shuma 5,389.16€ (Plotësim buxheti sipas mbetjeve për financim te projekteve te ndryshme).

PB – Zyra e Kryetarit - nënprogrami (16028):

KE – Subvencione dhe Transfere, shuma 23,889.19€ (Plotësim buxheti sipas mbetjeve për financim te projekteve te ndryshme).

PB – Shërbimet e shëndetësisë primare - nënprogrami (74700):

KE – Mallra dhe Shërbime, shuma 10,775.00€. Bartje e mjeteve nga mbetjet ne KE-Mallra dhe Shërbime të së njëjtit nenprogram prej 5,775.00 euro dhe nga KE-Shërbime Komunale nga nenprogrami i njëjtë 74700 në shumë prej 5,000 euro të vlerësuara si të panevojshme. Barten ne nenprogramin 74700 për shkak te mbulimit te shumë nevojave për furnizime mjekësore, higjienike etj. për QKMF-ën ne Kaçanik.

6. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi janë; Shtojcat A dhe B të pasqyrave tabelare e bilanceve të pa shpenzuara nga vitet fiskale 2023 dhe 2024 dhe rindarja e mjeteve të bartura në buxhetin e vitit 2025 në Nënprogramet përkatëse, kategoritë ekonomike dhe kodet e projekteve.

7. Për realizimin e këtij Vendimi, obligohet Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, e cila drejtori të njëjtin vendim do ta përcjellë në Ministrinë e Financave Punës dhe Transfereve.

8. Ky Vendim hyn në fuqi sipas nenit 17 të Rregullores (MAPL) Nr.02/2021- për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të komunës.

Me këtë Vendim të njoftohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Buxhet dhe Financa (përmes saj njoftohen organet tjera relevante), Arkivi.

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Mursej





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo
Ministria e Financëve / Ministarstvo za Finansije
Ministry of Finance
Arkiva - Arhiva - Archive

[illegible]


PRISHTINE/
 REPUBLIKA KOSOVË - REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
 QEVERIA E KOSOVES / QYRTA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVO

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
 Ministarstvo Lokalne Samouprave / Administration
 Ministry of Local Government Administration

Data: _____
 Datum: 16.06.2025
 Date: _____

Emri i organizatës	Nr i Lendës	Vlera
-VI-	020-355/3	

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Trasfera - Ministry of Finance, Labour and Transfers

Për:	Besim Ilazi Kryetar i Komunës së Kaçanikut	
Kopje:	Kemal Murseli, Kryesues i Kuvendit të Komunës Elbert Krasniqi, Ministër në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal Jeton Qela, Ud. Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal Njësia për Administrimin e Dokumenteve, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	
Përmes:	Avni Zogiani, Ministër në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve Arton Ahmeti, Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve	
Nga:	Bora Duli, Ud. Drejtoreshë e Departamentit Ligjor, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve	Datë: 10.06.2025
Zyrtarët përgjegjës:	1. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor 2. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor	Referencë: 100/2025
Lënda:	Konfirmim i ligjshmërisë së aktit të Komunës	
Lloji i aktit:	Vendim	

I nderuar Kryetar z. Ilazi,
I nderuar Kryesues z. Murseli,

Në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021, e në bazë të kompetencave ligjore të Ministrisë, të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren (QRK) Nr. 04/2021, Departamenti Ligjor i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë, ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-05 për Vetëqeverisje Lokale, aktin komunal si në vijim:

<i>Vendimi 01 Nr.104/02-11055/25 për bartjen e mjeteve vetanake të pa shpenzuara nga vitet paraprake në buxhetin e komunës të vitit 2025.</i>
<i>I miratuar me datë 30.05.2025</i>
<i>I parashtruar për shqyrtim në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal më datë 04.06.2025</i>
<i>I dërguar për shqyrtim në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve më datë 09.06.2025</i>

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (këtej e tutje referuar si "Ministria"), pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të mësipërm të Komunës së Kaçanikut, jep konstatimet ligjore të mëposhtme:

1. Komuna e Kaçanikut, me anë të aktit administrativ komunal synon bartjen e mjeteve vetanake të pa shpenzuara nga vitet paraprake në buxhetin e komunës të vitit 2025.
2. Në shqyrtimin e mundësisë së Komunës për realizimin e aktit administrativ komunal, Ministria ka konsultuar Ligjin Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-221, me Ligjin Nr. 04/L-116, me Ligjin Nr. 04/L-194, me Ligjin Nr. 05/L-063, me Ligjin Nr. 05/L-007 dhe me Ligjin Nr. 06/L-21 (këtej e tutje referuar si "LMFPP"). Po ashtu, është konsultuar dhe Ligji Nr.08/L-332 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025.
3. Kështu, në kuptim të ndarjeve buxhetore komunale, neni 9, paragrafi 6 dhe 7 i Ligjit Nr. 08/L-332 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për Vitin 2025, përcakton se në rast se shuma e të hyrave vetanake të Komunës gjatë vitit i kalojnë shumat e të hyrave të ndara të asaj komune ato mjete bartën në vitin 2025, si në vijim:

Neni 9

Ndarja dhe ri-ndarja e fondeve të bartura si dhe obligimet e pakryera financiar nga viti paraprak

6. Bilancet e pasqepënuara të të hyrave vetanake të komunave nga viti fiskal 2024 dhe vitet paraprake, të depozituara në Fondin e Kosovës dhe të regjistruara në SIMFK si ndarje buxhetore për një komunë, ndahen për vitin fiskal 2025 sipas autorizimeve të LMFPP-së.

7. Të hyrat vetanake të realizuara gjatë vitit 2024 dhe të regjistruara në SIMFK që kalojnë shumat e të hyrave të ndara në tabelën 4.1 për vitin 2024, barten në vitin 2025 në përputhje me vendimin e Kuvendit Komunal. Prioritet duhet të ketë ndarja e mjeteve për mbulimin e detyrimeve ekzistuese kontraktuale apo detyrimet që rrjedhin nga vendimet gjyqësore të formës së prerë.

4. Po ashtu, sipas nenit 27 të Ligjit 03-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë ndarjet buxhetore që ndërliken me të hyrat vetanake të pashpenzuara të komunës do të vazhdojnë për komunën përkatëse në vitin e ardhshëm fiskal, si në vijim:

Neni 27

Skudimi i ndarjeve buxhetore në fund të vitit fiskal

Të gjitha ndarjet buxhetore për vitin fiskal do të skadojnë në mesnatën e 31 Dhjetorit, me përjashtim të ndarjeve buxhetore të cilat ndërliken me të ardhurat vetanake të pashpenzuara të komunave, apo të ndonjë organizatë tjetër buxhetore të cilës i janë lejuar me ligj, e të cilat barten në vitin vijues.

5. Nisur mbi premisat e këtij argumentimi, mbetet evidente se organizata ka bërë ndryshimin e planit të buxhetit për vitin 2025 dhe ka bërë bartjen e të hyrave vetanake të pashpenzuara nga viti fiskal 2024. Përkundër kësaj, realizimi i suksesshëm i një procesi të tillë karakterizohet me detaje teknike buxhetore për të cilat organizatat buxhetore bashkëpunojnë ngushtë me Departamentin e Buxhetit.
6. Në këtë kuptim, Ministria konstaton se ligjërisht, Komunave ju mundësohet që këto bilance të përdoren për të financuar edhe projekte të reja dhe ekzistuese në vitin aktual, mirëpo realizimi i suksesshëm i tyre kushtëzohet me përputhshmërinë e materialeve përcjellëse të lendeve të proceduara nga Komuna në raport me udhëzimet dhe/apo rekomandimet e Departamentit të Buxhetit. Kjo nënkupton se vendimet e organizatave buxhetore mund të pësojnë ndryshime, konform rekomandimeve teknike të dhëna nga Departamenti i Buxhetit në Ministri.
7. Rrjedhimisht, akti administrativ i Komunës së Kaçanikut është në përputhje me legjislacionin në fuqi, - me kusht që Komuna të bashkëpunojë ngushtë dhe të veprojë sipas udhëzimeve dhe/apo rekomandimeve të Departamentit të Buxhetit.

Ministria mbetet në dispozicion të Komunës së Kaçanikut dhe/apo Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm lidhur me këtë vlerësim.

Me respekt!

Interpretimi i dhënë nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve përkitazi me këtë çështje mbështetet vetëm në këndvështrimet që prekin fushëveprimin legjislativ të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve